



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.03.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik Roza Komani B.I, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik Roza Komani B.I, e dt.11.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 05.03.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **05.03.2024;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Roza Komani B.I, me dt.11.03.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Sa i përket planit dinamik, Autoriteti kontraktues nuk ka caktuar prag dhe meqë Operatori ekonomik ka prezantuar planin dinamik më të shkurtër dhe në bazë të formulës për tenderin ekonomikisht më të favorshëm, është rekomanduar për kontratë, prandaj ky pretendim i juaji nuk qëndron;
2. Lidhur me stafit profesional, pretendimi juaj nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues ka kërkuar si dëshmi kontrata pune dhe Grupi i Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar kontrata pune me

KOSOVA • REP.

çka ka plotësuar kërkesat në FDT-ë . Nëse pretendoni se këtyre kontratave ju mungojnë elementet e kontratës siç parasheh Ligji i Punës, atëherë mendojmë se kjo është kompetencë e Inspektoriatit të Punës;

3. Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me inxhinierin e komunikacionit Egzon Tofaj, sqarojmë se Autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarime shtesë për inxhinierin në fjalë sepse i njëjti nuk ka pasur 5 vite përvojë pune. Grupi i Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë, përveç Egzon Tofaj ka prezantuar edhe inxhinierin tjetër të komunikacionit Uran Mulaj, me çka ka plotësuar kërkesat në FDT-ë, prandaj ky pretendim i juaji nuk qëndron;

4. Pretendimi juaj se lidhur me stafin profesional dhe numrin e punëtorëve nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë me nenin 72 të LPP-së, të cilat Grupi Operatorëve Ekonomik i ka sjellë dhe me këtë ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë.

5. Pretendimi juaj se Grupi Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë, në listën e pajisjeve ka paraqitur njërin cilindër me defekte dhe me këtë nuk plotëson kërkesat e FDT-së, nuk qëndron, sepse Marisa ka prezantuar rul –makinë me çka Grupi Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues siç është kërkuar në FDT.

6. Kërkesa e Autoritetit kontraktues në FDT-ë, ka qenë që për makineri, si dëshmi të prezantohet edhe dudi doganor ose fatura e blerjes. Grupi Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë për graider ka prezantuar kontratën e shitblerjes e dt.08.12.2006(mes shitësit dhe OE VAAKAL) dhe faturën e shitjes nr.266/06, me çka ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë, prandaj edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;

